



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.126/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit G.... shpk nga Prizreni kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.253/2017 të dates 02.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.10.2022, merr këtë,

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit G.... shpk nga Prizreni, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje administrative, A.nr.253/2017 i dates 02.07.2017, Vërtetohet.

### A R S Y E T I M

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.253/2017, të datë 02.07.2017, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) nr.16/2188/1-ZSP/267/16 dt.21.10.2016.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi G.... shpk nga Prizreni, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar, të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar që të bëjë analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha provave të administruara, përfshirë në veçanti vendimin e të paditurës, anulimi i të cilit është kërkuar me padi. Paditësi me parë është pajisur me kushtet ujore dt.14.09.2015 nga vet e paditura, për të cilat është nevojitur që të kryhen shumë analiza ndër të tjera edhe ekzistojnë koordinatat e sakta të projekteve P....., P..., P....., P....., e të cilat nuk bien ndesh me zonën e parkut kombëtar Sharr. Aktgjykimin e kundërshtuar me ankesë, gjykata e ka nxjerr me shkelje të dispozitave procedurale. Kështu në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar theksohet se nga hartat vërtetohet se prej gjithsej 38 koordinatave në GS vërehet se koordinatat shtrihen përgjatë Lumit Bistrica e Lumit manastirica përkatësisht vendbanimit Reqan dhe Urbiqan në Komunën e Prizrenit, mirëpo edhe pse nuk është kontestuese se shumica e koordinatave janë jashtë kufirit të parkut kombëtar Sharr por disa nga koordinatat ndodhen brenda zonës së dytë të mbrojtur të parkut Sharr. Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedural, sepse nuk ka dhënë arsye apo nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare.

E paditura, nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm, ka gjetur se

Ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura në procedurën administrative të ankesave ma aktvendimin kontestsues nr..... dt.21.10.2016, ka refuzuar kërkesën e paditësit për pëlqimin mjedisor lidhur me projektin për ndërtimin e hidrocentraleve P..... në lumin Manastricë dhe Lumbardh Komuna e Prizrenit. Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë 09.02.2017, për shkak të shkeljeve procedural nga e paditura, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm. Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, me arsyetim se qëndron arsyetimi i të paditurës se nga hartat vërtetohet se prej gjithsej 38 koordinatave në GS vërehet se koordinatat shtrihen përgjatë lumit Bistrica e lumit Manastrica përkatësisht vendbanimit Reqan dhe Urbican në Komunën e Prizrenit, mirëpo edhe pse nuk është kontestuese se shumica e koordinatave janë jashtë kufirit të Parkut Kombëtar Sharr por fakti se disa nga koordinatat ndodhen brenda zonës së dytë të mbrojtur të Parkut Sharr, kjo gjykatë me qëllim të ruajtjes së zonës së mbrojtur, ka vlerësuar dhe vendos si në dispozitiv të aktgjykimin. Në arsyetim të aktgjykimin gjykata e shkallës së parë referohet në Ligjin 04/L-087. Gjykata nuk aprovoi pretendimet e paditësit pasi që me asnjë provë të vetme si ka bërë të besueshme, se disa nga koordinatat nuk bien në zonën e mbrojtjes së Parkut Sharr.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, ky pretendim nuk qëndron për faktin se gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë të paditurës për përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, i ka thirrur palët në mënyrë të rregullt në seancë, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit të vendimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, sepse nuk ka dhënë arsye apo nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare., kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pa bazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, ngase vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitat të nenit 3

pika 1.2 e Ligjit nr.04/l-087 për Parkun Kombëtar, kjo për faktin se është vërtetuar në mënyrë të drejtë nga e paditura se paditësi ka planifikuar të ndërtoj hidrocentralin P... në lumin Manastriçë dhe Lumbardh Komuna e Prizrenit, ku disa nga koordinatat gjeografike të ofruara nga paditësi ndodhen brenda zonës së mbrojtur me ligj.

Nga e gjithë kjo që u theksua më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, dhe se thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit, në këtë kuptim ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.126/2022 datë 13.10.2022

Kryetari i kolegjit  
Krenar Berisha